

# ANALIZË E REGJISTRIMIT DHE VIJIMIT TË FËMIJËVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KLASËN E PARË DHE KLASAT PARAFILLORE





**ANALIZË E REGJISTRIMIT  
DHE VIJIMIT TË FËMIJËVE  
ROM, ASHKALI DHE  
EGJIPTIAN NË KLASËN  
E PARË DHE KLASAT  
PARAFILLORE**

KRAEEYN (Rrjeti i Kosovës për Edukimin e Hershëm të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian), është rrjet i profesionistëve dhe para-profesionistëve që kontribuojnë në zhvillimin në fëmijërinë e hershme të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. KRAEEYN është themeluar duke u bazuar në konceptin “Romani Early Years Network (REYN)”, iniciuar nga Asociacioni Ndërkombëtar ‘Hap pas Hapi’ (International Step by Step Association - ISSA). Deri më tani rrjeti KRAEEYN ka si anëtarë rreth 150 individë dhe organizata të cilët avokojnë për mirëqenien dhe përfshirjen në edukim cilësor dhe gjithëpërfshirës të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian. KRAEEYN vepron në kuadër të Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC).

**Analizë e regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom, ashkali, dhe egjiptian në klasën e parë dhe klasat parafillore**

2021, Prishtinë

**Autor**

Samir Shahini

Design: **envinion**

# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>7</b>
<b>2 HYRJE .....</b>	<b>9</b>
<b>3 KONTEKSTI .....</b>	<b>10</b>
3.1 Klasa parafillore ose “përgatitore” (mosha 5-6 vjeç) .....	10
3.2 Të dhëna të përgjithshme për Romët, Ashkalinjtë, dhe Egjiptianët në Kosovë .....	11
<b>4 KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI I ARSIMIT NË KOSOVË.....</b>	<b>13</b>
<b>5 ROMËT, ASHKALINJTË DHE EGJIPTIANËT NË SISTEMIN ARSIMOR .....</b>	<b>14</b>
<b>6 QENDRAT MËSIMORE NË KOSOVË.....</b>	<b>15</b>
<b>7 METODOLOGJIA HULUMTUESE.....</b>	<b>16</b>
<b>8 REZULTATET E HULUMTIMIT .....</b>	<b>17</b>
8.1 Pikëpamja e drejtorëve të shkollave.....	18
8.1.1 Përfshirja e nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në programin parafillor dhe klasën e parë .....	18
8.1.2 Stafi i shkollave, EPRBM-të, dhe Qendrat Mësimore .....	20
8.2 Pikëpamja e drejtorëve komunal për arsim dhe e zyrtarëve të zyrës komunale për komunitete dhe kthim.....	21
8.2.1 Përfshirja e nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në klasat parafillore dhe klasën e parë.....	21
8.2.2 Mos-regjistrimi dhe braktisja në klasën parafillore dhe klasën e parë.....	22
8.2.3 Rasti specifik i Zaskokut dhe Dubravës në Ferizaj.....	23
8.2.4 Të punësuarit në klasat parafillore dhe shkollat fillore nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian.....	23
8.3 Pikëpamja e përfaqësuesve të qendrave mësimore .....	24
8.3.1 Programi i Qendrave Mësimore .....	24
8.3.2 Vështirësitë e prindërve dhe qendrës mësimore.....	25
8.4 Pikëpamja e prindërve .....	26
8.4.1 Përshtypjet e përgjithshme të prindërve mbi programin parafillor dhe fillor, si dhe përfshirjen e fëmijëve të tyre këto programe.....	26
8.4.2 Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali, dhe egjiptian në klasat parafillore.....	29
<b>9 REKOMANDIME PËR PALËT E INTERESIT.....</b>	<b>31</b>

# LISTA E SHKURTESAVE

<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>BSFK</b>	Balkan Sunflowers Kosova
<b>KEEN</b>	Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim
<b>KOSINT</b>	Projekti “Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020”
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>QM</b>	Qendra Mësimore
<b>OJQ</b>	Organizata Jo-Qeveritare
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik për Arsim në Kosovë
<b>RADC</b>	Roma and Ashkali Documentation Center
<b>TDH</b>	Terre Des Hommes
<b>TIP</b>	The Ideas Partnership
<b>UA</b>	Udhëzimi Administrativ
<b>VoRAE</b>	Voice of Roma, Ashkali and Egyptians
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale Për Arsim
<b>ZKKK</b>	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
<b>EPRBM</b>	Ekipe për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
<b>SMIA</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim

# 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përgjithësi mund të konstatohet se pozita e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor në Kosovë, e në veçanti në klasat parafillore dhe ato fillore, nuk ka shënuar përmirësim të kënaqshëm, gjë e cila është dokumentuar edhe në raporte të tjera të publikuara nga organizata dhe institucione vendore, por edhe nga ato ndërkombëtare. Për më tepër, edhe pse situata vlerësohet të ketë pasur përmirësim të lehtë nga palët e përfshira në këtë hulumtim, duke filluar nga vetë prindërit rom, ashkali, dhe egjiptian, dhe udhëheqësit e shkollave, përfaqësues të Drejtorive Komunale për Arsim (DKA) dhe zyrtarë të Zyreve Komunale për Komunitete (ZKK) në komunat përkatëse të përzgjedhura për të realizuar këtë studim, në të njëjtën kohë raportohen shumë probleme dhe sfida të cilat edhe pse në vazhdimësi janë raportuar nuk kanë gjetur zgjidhje.

Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë informacione dhe analiza lehtë të kuptueshme, kryesisht kualitative, për këto probleme dhe sfida me të cilat përballen nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian në shkolla në këto nivele. Të dhënat në këtë raport janë siguruar nga intervistat në terren me palët e lartë-përmendura, nga dokumente të publikuara nga MASHTI dhe OJQ të cilat angazhohen dhe monitorojnë zhvillimin e edukimit parashkollor në Kosovë, por edhe nga vetë shkollat.

Kosova vazhdon të mbetet vend me nivel të ulët të përfshirjes së fëmijëve rom, ashkali, dhe egjiptian në edukimin e institucionalizuar parashkollor dhe fillor, ndërsa nuk vërehet qasje serioze dhe strategjike për të përmirësuar këtë gjendje në një të ardhme të afërt. Të dhënat në përqindje të fëmijëve të moshës së fillimit për shkollë fillore që hyjnë në klasën e parë tregojnë se norma neto e regjistrimit në arsimin e detyruar është pak mbi 87.9% (duke shënuar rënie nga Anketa e Treguesve të Shumëfishtë e realizuar në vitin 2013/14, e cila ishte 91.6%) në popullatën e përgjithshme, derisa tek komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian është dukshëm më e ulët 69.1% (por që megjithatë ka shënuar një ngritje të lehtë nga 68.1% sa ishte në vitin 2013/14)<sup>1</sup>. Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që aktualisht ndjekin shkollën fillore ose të mesme është 96.1% tek popullata e përgjithshme (e cila ka shënuar rënie nga 98%, pra 1.9% rënie), dhe 84.1% tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (që i bie të ketë pasur rënie nga Anketa e Treguesve të Shumëfishtë e realizuar në vitet 2013/4, nga 85.3%, pra 1.2% rënie). Sa i përket përqindjes së fëmijëve të moshës së shkollës fillore që nuk ndjekin edukimin në fëmijëri të hershme, shkollën fillore ose të mesme të ulët, tek popullata e përgjithshme është 2.1%, tek komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian është dukshëm më e lartë me 13.2%<sup>2</sup>.

Nuk është punuar mjaftueshëm për eliminimin e diskriminimit dhe racizmit në shkolla<sup>3</sup>, sidomos në ato shkolla që punojnë ndarazi në sistemin paralel serb ku ende ka klasa të segreguara<sup>4</sup>, sigurimin e programeve edukative cilësore, rritjen e përfshirjes së prindërve të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian, faktor këta të cilët do të siguronin përfshirjen plotë të fëmijëve në shkollimin fillor, dhe përgatitjen e duhur të fëmijëve për shkollimin e mëtejshëm.

<sup>1</sup> Anketa e Treguesve të Shumëfishtë 2013/14 - faqe 7, UNICEF

<sup>2</sup> 2019–2020 Anketa e Treguesve të Shumëfishtë dhe Komunitetet Rom, Ashkali, faqe 24, UNICEF

<sup>3</sup> Raport tematik: Vështirësitë e nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në shkollim, faqe 28 - KEC përmes projektit KOSINT

<sup>4</sup> Raport tematik: Vështirësitë e nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në shkollim, faqe 33 - KEC përmes projektit KOSINT

Hulumtimi ofron dëshmi për situatën aktuale dhe jep rekomandime të cilat do të shprijnë drejt përmirësimit të kësaj situatë në edukim në këto nivele, kur dihet se të gjitha vendet e zhvilluara vite më parë kanë rritur investimet në edukimin e fëmijëve dhe rritjen e përfshirjes, dhe në këtë mënyrë kanë arritur të shënojnë rezultate të prekshme në të ardhmen e gjeneratave.

Disa nga të gjeturat kryesore të analizës tregojnë se drejtorët komunal për arsim, përfaqësues të ZKKK-ve, si dhe përfaqësues të qendrave mësimore konsiderojnë se arsye kryesore për regjistrim dhe vijueshmëri jo të kënaqshme në programin parafillor është vetëdija e ulët e prindërve të nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian, derisa kjo nuk del të jetë edhe mendimi i këtyre të fundit. Në fshatin Zaskok të Ferizajit, edhe pse ekziston klasa parafillore në shkollën Naim Frashëri, nxënësit nuk vijnë fare aty por ndjekin shërbimet që ofrohen për këtë grupmoshë në qendrën mësimore të Caritas në fshatin Dubravë. Në anën tjetër në Fushë Kosovë në 3 shkollat fillore të qytetit nuk organizohet fare program parafillor për nxënës të kësaj grupmoshe, për shkak të mungesës së hapësirave dhe me numrit të kufizuar stafit. 90% e prindërve të intervistuar deklarojnë se asnjëherë nuk janë kontaktuar nga shkolla apo komuna në lidhje me shërbimin e programit parafillor.

Ky raport përveç synimit që të informojë opinionin publik në lidhje me situatën në të cilën ndodhemi, synon edhe të rris angazhimin e të gjitha palëve, në veçanti të institucioneve në fushën e arsimit, që të investojnë në edukim më cilësor dhe të rrisin gjithëpërfshirjen e të gjithë fëmijëve në Kosovë pa dallim.



## 2. HYRJE

Edukimi parashkollor paraqet nivelin e parë të arsimit parauniversitar në Kosovë, përkatësisht shkallën 0 të Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (ISCED)<sup>5</sup>, në të cilën përfshihen fëmijët deri në moshën 6 (gjashtë) vjeçare. Edukimi parashkollor në Kosovë, organizohet në institucionet parashkollore publike (çerdhet dhe kopshtet) dhe institucionet parashkollore private, qendrat/kopshtet me bazë në komunitet dhe klasat përgatitore të cilat funksionojnë në kuadër të shkollave fillore (niveli parafillor).

Pavarësisht një numri të madh të ligjeve, rregulloreve dhe dokumenteve tjera që në letër mbrojnë të drejtat e fëmijëve përbrenda legjislacionit të Kosovës, fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të jenë të prekur nga niveli i ulët i përfshirjes, duke u bërë kështu, në numra të lartë, viktimë e braktisjes së hershme të shkollimit dhe angazhimit të tyre në punë të rënda.

Procesi i përfshirjes të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në arsim është adresuar nëpërmjet një sërë ligjesh, dy strategjive kombëtare për përfshirjen e komuniteteve Rom, Ashkali, dhe Egjiptian, dhe disa udhëzimeve administrative të hartuara nga ministrinë e linjës. Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021<sup>6</sup> e miratuar në Prill të vitit 2017 nga Qeveria e Kosovës, e parasheh arsimin si një nga katër shtyllat kryesore të intervenimit. Në fushën e arsimit, ka një numër aktivitete të cilat janë paraparë të adresohen përgjatë katër viteve të strategjisë. Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017-2021<sup>7</sup> gjithashtu parasheh masa konkrete për rritjen e pjesëmarrjes dhe cilësinë e arsimit në nivelet parafillore dhe fillore për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Në anën tjetër një numër i konsiderueshëm i organizatave jo-qeveritare kanë zhvilluar programe të ndryshme të ofrimit të ndihmës në mësim-nxënie për nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian siç është mësimi plotësues, programet parashkollore, programet verore, programe të ndërmjetësimit me komunitetin, si dhe programe të përkrahjes së të rinjve në lokacione të ndryshme në Kosovë ku janë të përqëndruara këto komunitete.

Ky studim analizon gjendjen e regjistrimit dhe vijueshmërisë së nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në shkolla në Kosovë në klasat parafillore dhe klasat e para të nivelit fillor, si dhe sfidat me të cilat përballen këta nxënës.

5 Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit, 2012, faqe 26 - ISCED 2011

6 Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë në shoqërinë kosovare 2017-2021 - Zyra për Qeverisje të mirë në kuadër të Kryeministrit të Republikës së Kosovës

7 Plani strategjik i arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021 - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

## 3. KONTEKSTI

Në bazë të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Kosovë<sup>8</sup>, edukimi parashkollor në Kosovë, organizohet në dy nivele. Niveli i parë, përfshin moshën prej lindjes deri në moshën 5 vjeçare (i ndarë në grup moshat lindje deri në 3 vjeç dhe 3 deri në 5 vjeç) dhe niveli i dytë moshën 5 deri në 6 vjeç, pas së cilës fëmijët, sipas ligjit regjistrohen në shkollën fillore.

Klasifikimi Standard Ndërkombëtar	Nivelet formale të arsimit parauniversitar	Grupmoshat që mbulon
 <b>KSNA 2</b>	Arsimi i mesëm i ulët KLASAT VI-IX	<b>11-14</b>
 <b>KSNA 1</b>	Arsimi fillor KLASAT I-V	<b>6-10</b>
 <b>KSNA 0</b>	Klasa përgatitore	<b>5-6</b>
	Edukimi parashkollor	<b>lindje-5</b>

**Tabela 1.** Strukturimi dhe organizimi i kurrikulës sipas shkallëve

### 3.1 Klasa parafillore ose “përgatitore” (mosha 5-6 vjeç)

Termi “klasat përgatitore” për herë të parë në legjislacionin e edukimit parashkollor në Kosovë, haset në dokumentin e kurrikulës bërthamë të rishikuar në vitin 2016, ndërsa, në të gjithë legjislacionin duke përfshirë këtu edhe Ligjin për arsimin parauniversitar të Kosovës dhe dokumentacionin tjetër ligjor e pedagogjik, (madje edhe brenda vet kurrikulës bërthamë për klasat përgatitore) përdoret termi “klasa parafillore”<sup>9</sup>. Klasa përgatitore, siç është konceptuar në kurrikulën bërthamë duhet të zhvillojë kompetencat e fëmijëve të kësaj grup moshe, ndërsa rezultatet e të nxënësve janë

<sup>8</sup> Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)  
<sup>9</sup> Edukimi parashkollor në Kosovë, faqe 12 - KEC përmes projektit KEEN

të përbashkëta me klasën e parë dhe klasën e dytë në arsimin fillor dhe vlerësimi i tyre realizohet në fund të klasës së dytë apo shkallës së parë të kurrikulës.


Klasat parafillore janë të përfshira në ligjin për arsimin parauniversitar në Kosovë, të cilat kanë filluar të organizohen shumë më herët, por me këtë ligj, ato rregullohen në mënyrë të veçantë, duke synuar që arsimi parafillor të bëhet pjesë e arsimit të detyruar nga viti 2015. Megjithatë, kjo synohet të arrihet vetëm pasi të bëhet një analizë financiare e kostos së përfshirjes së të gjithë fëmijëve në arsimin parafillor. Sipas këtij ligji, arsimi parafillor organizohet si pjesë e Nivelit 0 (arsimi parashkollor, moshë 0 - 6 vjeç) dhe pjesë e shkallës 1 të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës.<sup>10</sup> Përkundër këtij synimi, për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe pamundësisë që të gjithë fëmijët në Kosovë të mund të përfshihen në klasat përgatitore, arsimi parafillor vazhdon të mos jetë i detyruar as në vitin shkollor 2020/21.

Përqindja e fëmijëve të moshës 36–59 muaj që vijojnë një program arsimor të fëmijërisë së hershme në përgjithësi në Kosovë është 15%, derisa tek komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian është 7.6%<sup>11</sup>. Ndërsa përqindja e fëmijëve në grupmoshën përkatëse (një vit para moshës zyrtare eregjistrimit në shkollë fillore) që ndjekin një program arsimor të fëmijërisë së hershme ose shkollën fillore tek popullata e përgjithshme e Kosovës është 83.8%, në krahasim me vetëm 44.9% të atyre nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian në Kosovë<sup>12</sup>.

### 3.2 Të dhëna të përgjithshme për Romët, Ashkalinjtë, dhe Egjiptianët në Kosovë

Të dhënat për popullsinë e përgjithshme dhe ato të komuniteteve etnike vijnë nga regjistrimi i fundit i popullsisë i kryer në vitin 2011. Një total prej 8,824 ose 0,5% të popullsisë së përgjithshme janë rom, 15,436 (që është 0,9% e popullsisë së përgjithshme) janë ashkali dhe 11,524 (0,7% e popullsisë së përgjithshme) janë egjiptian<sup>13</sup>.

#### Numri i banorëve rom, ashkali, dhe egjiptian në Kosovë



**Grafiku 1** – Popullsia rome, ashkali, dhe egjiptiane në Kosovë

<sup>10</sup> Arsimitimi - detyrim i një shteti vizionar - Qëndrimi i KOMF për përfshirjen e fëmijëve në arsimin parafillor, 2014 - KOMF

<sup>11</sup> 2019–2020 Anketa e Treguesve të Shumëfishtë dhe Komunitetet Rom, Ashkali, faqe 24 - UNICEF

<sup>12</sup> 2019–2020 Anketa e Treguesve të Shumëfishtë dhe Komunitetet Rom, Ashkali, faqe 24 - UNICEF

<sup>13</sup> Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave të Kosovës 2011 - Rezultatet përfundimtare, 14 shtator 2012, faqe 143 - Agjencia e Kosovës për Statistika

Komuniteti rom jeton në tërë Kosovën, me përqendrim kryesisht në komunat e Prizrenit, Pejës, Graçanicës, Gjakovës, Obiliqit dhe Mitrovicës. Të dhënat zyrtare tregojnë për 8,824 qytetarë rom në Kosovë. Shumica e romëve janë myslimanë sunitë dhe flasin gjuhën rome, gjuhë kjo që dallon nga gjuhët zyrtare në Kosovë. Në disa komuna, komuniteti romë përbën ndërmjet 2% dhe 5% të popullsisë komunale<sup>14</sup>.

Komuniteti ashkali është më i madhi nga këto tre komunitete me 15,436 pjesëtarë. Komuniteti ashkali jeton kryesisht në zona urbane, me përqendrim në komunat e Ferizajt, Fushë Kosovës, Lipjanit, Prizrenit dhe Shtimes. Ata përgjithësisht janë myslimanë sunitë dhe flasin gjuhën shqipe.<sup>15</sup>

Komuniteti egjiptian përbëhet nga 11,524 pjesëtarë ose më pak se 1% e popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Egjiptianët jetojnë kryesisht në zona urbane me përqendrim në masë të madhe në komunat e Gjakovës, Pejës, Istogut, Deçanit dhe Klinës. Ata janë përgjithësisht myslimanë sunitë dhe flasin gjuhën shqipe si gjuhë amtare.<sup>16</sup>

Komunitetet më të mëdha jetojnë në komunat si Gjakovë (shumica egjiptianë), Fushë Kosovë (shumica ashkalinj), Prizren (shumica romë), Pejë (shumica egjiptianë), Ferizaj (shumica ashkalinj), Lipjan (shumica ashkalinj) dhe Istog (shumica egjiptianë).

Këto komunitete vazhdojnë të jenë grupi më pak i përfshirë në arsimin parafillor dhe fillor, dhe shumë pak i përfshirë atë të mesëm dhe të lartë. Gjithashtu, fëmijët rom, ashkali, dhe egjiptian janë ata të cilët përbëjnë pjesën më të madhe të fëmijëve që ose kanë braktisur shkollimin, ose janë në rrezik braktisjeje.

Përveç faktit se të drejtat themelore janë garantuar nga kushtetuta e vendit dhe të drejtat për arsim janë të bazuara në ligjin për arsimin para-universitar si legjislacion ombrellë në arsim, ekzistojnë edhe një numër ligjesh që drejtpërsëdrejti prekin mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut:

- Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë (03/L-047).
- Ligji për arsimin në komuna i cili parasheh një përgjegjësi më të madhe për vendimmarrjen e nivelit lokal (03/L-068).
- Ligji kundër diskriminimit (2004/3).
- Ligji për përdorimin e gjuhëve (02/L37).
- Ligji për trashëgiminë kulturore (02/L-88).

Kosova përgjithësisht mund të konsiderohet si një vend që i ka dhënë një fokus të kënaqshëm promovimit të diversitetit dhe të drejtave të njeriut për të gjithë njerëzit e saj, pavarësisht racës, përkatësisë etnike apo fesë, së paku në kornizën ligjore të saj. Megjithatë, situata në teren tregon se mungojnë ose janë të pafuqishëm mekanizmat për zbatimin e kësaj kornize ligjore.

14 Profili i komunitetit: Komuniteti Rom - Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë

15 Profili i komunitetit: Komuniteti Ashkali - Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë

16 Profili i komunitetit: Komuniteti Egjiptian - Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë

## 4. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI I ARSIMIT NË KOSOVË

Arsimi ka rol të rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik të një vendi, duke iu mundësuar kështu individëve të shfrytëzojnë potencialin e tyre dhe të luajnë rol produktiv në zhvillimin e shoqërisë. Si i tillë, përveç në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021<sup>17</sup>, arsimi zë vend prioritar në dokumente të ndryshme strategjike të Qeverisë së Kosovës, përfshirë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillimit (SKZh)<sup>18</sup>, Agjendën për Reforma Evropiane (ARE)<sup>19</sup>, Programin për Reforma në Ekonomi (PRE), Strategjinë për Përfshirje të Komuniteteve Rom, dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021, dhe Programin Qeverisës të Republikës së Kosovës.

Disa nga dokumentet ligjore dhe strategjike të cilat përcaktojnë organizimin dhe zhvillimin e edukimit parashkollor në Kosovë janë:

- Ligji Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor<sup>20</sup>
- Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet dhe Republikës së Kosovës<sup>21</sup>
- Ligji nr. 04/ L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë<sup>22</sup>
- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar<sup>23</sup>
- Kurrikula Bërthamë për klasat përgatitore dhe arsimin fillor<sup>24</sup>

17 Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021 - Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (MASHT)

18 Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021 - Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës

19 Dialogu i Nivelit të Lartë Kosovë - BE për Prioritetet Kyçe, Agjenda për Reforma Evropiane - Qeveria e Republikës së Kosovës

20 Ligji Nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor, 2006 - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

21 Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet dhe Republikës së Kosovës - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

22 Ligji nr. 04/ L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, 2011 - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

23 Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, 2016 - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

24 Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor në Kosovë, 2016 - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

## 5. ROMËT, ASHKALINJTË DHE EGJIPTIANËT NË SISTEMIN ARSIMOR

Fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës vazhdojnë të përballen me sfida në qasjen në arsim cilësor dhe janë jo-proporcionalisht në krahasim me popullatën shumicë, të prekur nga mosregjistrimi, braktisja, analfabetizmi në shkallë të lartë, si dhe arritje të ulëta arsimore.<sup>25</sup> Në tetor të vitit 2012, MASHT-i nxori një Udhëzim Administrativ duke i dhënë institucioneve arsimore në nivel komunal përgjegjësi për themelimin dhe funksionalizimin e “ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit në arsimin e detyrueshëm” (EPRMB).<sup>26</sup> Më tutje, MASHT-i, në tetor 2014, zhvilloi dhe aprovoi termat e referencës për të ndihmuar në operimin e ekipeve EPRMB. Duke qenë të obligueshme në nivel shkolle dhe komune, EPRMB-të kanë për qëllim të bashkërendojnë veprimet për t’i trajtuar braktisjet dhe për ta luftuar regjistrimin e ulët dhe pritet nga to të ofrojnë mbështetje të veçantë për fëmijët e këtyre tre komuniteteve.

Në anën tjetër, nuk është arritur progres në adresimin e çështjes së ekzistimit të dy sistemeve të ndara të arsimit që në mënyrë të pashmangshme ndikon në ndarjen edhe më tej të komuniteteve. Përkundër rekomandimeve të Komisionit të pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore gjuhësore në gjuhën serbe të publikuara në vitin 2010 për rëndësinë e një sistemi unik arsimor për të gjitha komunitetet në Kosovë<sup>27</sup> nuk janë ndërmarra përpjekje serioze për trajtimin e ofrimit të veçantë të mësimin në gjuhën serbe, kryesisht për shkak të rrethanave të përgjithshme politike. Për më tepër, nuk janë bërë shumë përpjekje qoftë për nxënësit shqiptarë të Kosovës, qoftë për ata serbë të Kosovës t’i mësojnë gjuhët e komunitetevetjera, gjë që do të ndihmonte në ruajtjen dhe promovimin më të mirë të gjuhës dhe kulturës rome në veçanti. Përgjithësisht, reforma e vazhdueshme arsimore në Kosovë ende nuk i ka adresuar këto nevojat të përbashkëta për mësim të gjuhëve, arsimim dhe integrim.

Mundësitë për ndërveprim ndërmjet nxënësve që ndjekin mësimet në dy sistemet e ndara arsimore kufizohen në iniciativa të shpërndara dhe të rralla të ndërmarra nga organizatat ndërkombëtare apo organizatat jo-qeveritare lokale. Ndërveprimi midis nxënësve nga komunitete të ndryshme madje edhe brenda vetë sistemit të njëjtë arsimor është gjithashtu i kufizuar dhe ndonëse ngjarjet e përgjithshme kulturore dhe sportive organizohen nga vetë shkollat, aktivitetet me qëllim promovimin e dialogun dhe kontaktin ndëretnik organizohen kryesisht nga OJQ-të.<sup>28</sup>

Një dokument i një rëndësie madhore është edhe Udhëzimi Administrativ për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore 19/2018<sup>29</sup>, i cili u mundëson qendrave mësimore të regjistruhen dhe të kalojnë gradualisht në përgjegjësi financiare dhe administrative të komunave përkatëse.

25 Gjendja e komuniteteve në komunat e Kosovës, faqe 14 - KEC përmes projektit KEEN

26 Udhëzimi administrativ nr. 19/2012 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e detyrueshëm - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

27 Komisioni i pavarur i MASHT për shqyrtimin e materialeve mësimore në serbisht, f. 15 - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

28 Disa nga organizatat që veprojnë në këtë fushë janë Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), Voice of Roma, Ashkali, and Egyptians (VoRAE), Roma and Ashkali Documentation Center (RADC), dhe Terre des hommes (TDH).

29 Udhëzimi Administrativ 19/2018 Për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

## 6. QENDRAT MËSIMORE NË KOSOVË

Roli i Qendrave Mësimore është të ofrojnë shërbime plotësuese ose alternative arsimore për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian në lokalitetin ku ushtron veprimtarinë, me qëllim të përfshirjes dhe përmirësimit të performancës së tyre në shkollë dhe integritet të tyre në shoqërinë e gjerë. Qendrat Mësimore funksionojnë me bazë në komunitet dhe me bazë në shkollë. Aktualisht, mbi 50 Qendra Mësimore veprojnë në 20 komuna të Kosovës, kryesisht në komunat ku jetojnë shumica e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këto qendra udhëhiqen nga më shumë se 10 organizata të shoqërisë civile në Kosovë me mbështetje financiare kryesisht të donatorëve ndërkombëtar. Numri më i madh i Qendrave Mësimore është në komunat e Gjakovës, Prizrenit, Pejës dhe Lipjanit.

Sipas të dhënave të ofruara nga organizatat jo-qeveritare që menaxhojnë Qendrat Mësimore, janë gjithsej 5,555 fëmijë që vijnë në aktivitetet në Qendra Mësimore, ku numri i fëmijëve nga të dy gjinitë është pothuajse i barabartë. Komunat e Fushës Kosovës, Gjakovës dhe Shtimes kanë numrin më të madh të fëmijëve që vijnë në aktivitetet në Qendra Mësimore. Qendrat Mësimore operojnë kryesisht nëpërmjet mbështetjes financiare nga donatorët, dhe kjo mbështetje nuk është e qëndrueshme<sup>30</sup>.

---

<sup>30</sup> Ndikimi i Qendrave Mësimore në Kosovë, faqe 7 - KEC përmes projektit KOSINT

## 7. METODOLOGJIA HULUMTUESE

Metodologjia e përdorur për këtë analizë të regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom, ashkali, dhe egjiptian në klasën e parë dhe klasat parafillore kombinohet duke u bazuar në të dhënat nga raportet dhe statistikat në dispozicion në nivel kombëtar dhe nivel komunal në njërin anë, dhe të dhënat e mbledhura nga komunat e Prizrenit, Ferizajit, Fushë Kosovës dhe Obiliqit përmes intervistave të realizuara me akterë të ndryshëm të përfshirë në tematikën e trajtuar nga analiza, për qëllime të këtij vlerësimi të veçantë. Në anën tjetër, raportet që u analizuan për të mbledhur të dhëna për këtë vlerësim përfshijnë:

- Raportet statistikore të MASHT për vitin 2016, 2017 dhe 2018 (të cilat dalin nga divizioni SMIA),
- Raporti i projektit KEEN 2018 – Edukimi Parashkollor në Kosovë
- Raporti i projektit KOSINT 2020 - Integrimi i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor në Kosovë,
- Raporti i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve në Kosovë nga OSCE, 2015,
- Raporti i projektit KOSINT 2020 - Ndikimi i Qendrave Mësimore në përfshirjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim
- Raporti vjetor i projektit KOSANA për vitin 2015

Ndërkaq, të dhënat nga tereni janë mbledhur përmes organizimit të intervistave të strukturuar me pyetje të hapura dhe të mbyllura në secilën nga katër komunat e përzgjedhura për hulumtim – Fushë Kosovë, Prizren, Obiliq, dhe Ferizaj. Komunat janë përzgjedhur në dakordim të ngushtë me menaxheren e projektit dhe personat tjerë të përfshirë në projekt.

Intervistat janë realizuar me 5 drejtor të shkollave fillore në komunat përkatëse: Naim Frashëri në Zaskok të Ferizajit, Haziz Tola në Arbanë të Prizrenit, Daut Bogujevci në Fushë Kosovë, Pandeli Sotiri në Obiliq, si dhe Sveti Sava në Plemetin të Obiliqit; me 21 prindër të nxënësve të ciklit parafillor dhe fillor nga komunat e përfshira në analizë; 4 drejtorë ose përfaqësues komunal për arsim; 4 zyrtar komunal për komunitete dhe kthim; si dhe 5 përfaqësues të qendrave mësimore në komunat e përfshira në analizë.

Pyetësorët për secilin target-grup të të intervistuarve janë dizajnuar si të veçantë, dhe kanë përmbajtur 11 deri në 13 pyetje, varësisht nga grupi, me ndihmën e të cilëve janë zhvilluar intervistat me pjesëmarrësit, për të nxjerrë informata më të plota dhe më reale nga situata në teren. Të dhënat nga intervistat e realizuara janë vendosur në një matriks të detajuar, dhe pastaj nga ky matriks janë nxjerrë të dhënat kualitative dhe ato kuantitative të hulumtimit.



## 8. REZULTATET E HULUMTIMIT

Nga analiza e bërë mbi raporte dhe të gjetura nga hulumtime paraprake, e më pastaj edhe përmes intervistave të realizuara në katër komuna të ndryshme të Kosovës, del që fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian në Obiliq (pjesërisht), Fushë Kosovë dhe Ferizaj nuk vijnë në programin parafillor në shkollë. Ata në masë të madhe janë pjesë e programeve parafillore kryesisht të organizuara në qendra mësimore. Në anën tjetër, në Prizren dhe në Obiliq në sistemin paralel serb, ata në masë të madhe vijnë në programin parafillor të organizuar në shkollë. Sa i përket regjistrimit në klasë të parë sipas Anketës së Indikatorëve të Shumëfishtë të UNICEF për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët në Kosovë, vetëm 69,1% të nxënësve të këtyre komuniteteve në moshë për regjistrim në klasë të parë realisht regjistrohen, derisa kjo përqindje tek shqiptarët në Kosovë është 87,9%<sup>31</sup>. Megjithatë ata vazhdojnë të përballen me sfida të shumta në rrugëtimin e tyre të edukimit. Problem kryesor vazhdon të jetë vijueshmëria e parregullt, dhe braktisja e shkollimit sidomos në nivelin e mesëm të ulët. Mungesa e përkrahjes nga prindërit për shkak të vetëdijes së ulët të një numri të konsiderueshëm të tyre, dhe mos vlerësimit të shkollimit nga ana e tyre, hapësirave të papërshtatshme për punë në disa shkollë, numri i madh i nxënësve në klasa, distanca nga shkollë, kushtet ekonomike dhe sociale të familjeve, janë vetëm disa nga sfidat me të cilat nxënësit përballen. Tutje, analiza ka nxjerrë në pah faktorë dhe pengesa të shumta me të cilat nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian përballen në veçanti, të cilat do të elaborohen në vazhdim sipas pikëpamjeve të të gjithë akterëve të intervistuar për nevoja të këtij hulumtimi.

Palët e përfshira në hulumtim, kanë pikëpamje të ndryshme sa iu përket arsyeve dhe faktorëve të ndryshëm që kanë çuar në një situatë të tillë, dhe mbi rrugëdaljet apo zgjidhjet më të mira për të rritur regjistrimin dhe vijueshmërinë e nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në klasat parafillore dhe klasat e para të shkollave fillore në Kosovë. Megjithëse shumica pajtohen se duhet bërë më tepër në sigurimin e kushteve më të mira dhe përshtatshme për organizim të programit parafillor sipas standardeve për këtë moshë, por edhe për klasat e para, duhet të luftohet trajtimi jo i duhur në shkollë në përgjithësi dhe në të gjitha instancat, si dhe duhet të punohet me prindërit më tepër për vetëdijësimin e tyre mbi rëndësinë e shkollimit e fëmijëve të tyre në moshë të hershme, ata pajtohen edhe për faktin se duhet rritur bashkëpunimi ndër-institucional si çelës për përmirësimin e situatës.


31 Anketa e regjestrimit të shumëfishtë (MICS), faqe 24 - UNICEF

## 8.1 Pikëpamja e drejtorëve të shkollave


### 8.1.1 Përfshirja e nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në programin parafillor dhe klasën e parë

Edhe pse në komunat e Ferizajit dhe Obiliqit të dhënat DKA-të nuk arritën të sigurojnë të dhëna numerike mbi përfshirjen e nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian, të dhëna në numra u siguruan nga drejtorët e shkollave të përfshira në këtë intervistë, por edhe nga Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim - SMIA. Të dhëna të ngjashme nuk u siguruan nga drejtori i shkollës Haziz Tola në Prizren, duke qenë se ishte rishtazi i angazhuar në këtë pozitë dhe nuk kishte ende informata mbi numrin e nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në shkollën me të cilën ai tashmë menaxhon. Performanca e përgjithshme e këtyre nxënësve cilësohet si e dobët nga drejtorët e shkollave në Ferizaj, Fushë Kosovë dhe Prizren, derisa në Obiliq, përkatësisht në fshatin Plemetin drejtori konsideron se është deri diku e mirë.

#### Numri i nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian sipas gjinisë në klasën e parë



Naim Frashëri - Ferizaj  
(klasën e parë)



Daut Bogujevci -  
Fushë Kosovë




Pandeli Sotiri -  
Obiliq


#### Grafiku 2 – Numri i nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në klasën e parë

Të regjistruar në klasën e parë në shkollën Naim Frashëri janë 51 nxënës ashkali, nga të cilët 27 janë vajza. Fatkeqësisht në klasën parafillore nuk ka asnjë nxënës të regjistruar në këtë shkollë nga komuniteti ashkali edhe pse ekziston klasa parafillore në shkollë, por të njëjtit, pra 30 fëmijë nga të cilët 22 janë djem, ndjekin shërbimin parafillor në qendrën mësimore të udhëhequr nga Caritas, në fshatin Dubravë. Derisa në Fushë Kosovë nuk ka klasa parafillore në shkollat e qytetit, në shkollën Daut Bogujevci janë nxjerrë informata vetëm për klasën e parë, ku në total janë 32 nxënës ashkali, nga të cilët 15 janë vajza. Në Obiliq në fshatin Plemetin në të dy sistemet (të Kosovës dhe atë paralel të Serbisë) klasat parafillore numërojnë 20 nxënës të komuniteteve rom dhe ashkali, nga të cilët 8 janë vajza, nga të cilët 10 janë në sistemin paralel të Serbisë – 6 djem e 4 vajza.

### Djem në nivelin parafillor



### Vajza në nivelin parafillor



■ Ferizaj (QM) ■ Obiliq (Shqip) ■ Obiliq (Serbisht) ■ Fushë Kosovë ■ Prizren (nuk ka të dhëna)

**Grafiku 3** – Numri i nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në nivelin parafillor


Në aspektin e socializimit apo shoqërimit të nxënësve shqiptar dhe atyre të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian në nivelin parafillor dhe klasën e parë, vlerësohet se situata është mjaftë e mirë sipas drejtorite të shkollës Daut Bogujevci në Fushë Kosovë, i cili thekson se në masë të madhe kjo është meritë e stafit të shkollës, i cili angazhohet jashtëzakonisht shumë për të shtyrë nxënësit të socializohen mes vete.

Në anën tjetër, vijueshmëria vlerësohet brengosëse pothuajse të gjitha palët e përfshira në këtë hulumtim. Përjashtim bënë shkolla Haziz Tola në Prizren, drejtori i së cilës shprehet se në nivelin parafillor dhe klasat e para të shkollës nuk kanë problem me vijueshmëri, por problemet shfaqen në klasat e ciklit të mesëm të ulët. Drejtorët në disa raste vlerësojnë se ka shume neglizhencë nga prindërit për t'i dërguar fëmijët në shkollë. Një masë që ka rezultuar pozitive është ndarë nga drejtori i shkollës Pandeli Sotiri në Obiliq (Plemetin), i cili thekson se bazuar në Udhëzimin Administrativ 13/2005 - Masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar<sup>32</sup>, ka nxjerrë një vërejtje për të gjithë prindërit fëmijët e të cilëve nuk kanë vijuar me rregull. Kjo ka rezultuar mjaftë e suksesshme. Për më tepër, ai sygjeron edhe një masë tjetër e cila po të aplikohet në shkollë vendi që do të ulte dukshëm numrin e mungesave dhe braktisjes së shkollës. Fjala është për vërtetimin që QPS kërkon nga prindërit për vijimin e shkollës nga fëmijët e tyre, dokument i cili kërkohet vetëm një herë në vit, e cili do të duhej të kërkohet së paku një herë në dy muaj.

<sup>32</sup> UA mbi masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Në grafikun më poshtë janë paraqitur disa nga vështirësitë me të cilat përballen nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian për regjistrim dhe vijueshmëri të rregullt në shkolla, të raportuara nga drejtorët e shkollave.

#### Vështirësitë me të cilat përballen nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian sipas drejtorëve të shkollave



- Mos-interesimi i prindërve
- Vështirësitë socio-ekonomike
- Mungesa e transportit ose shoqërimit për në shkollë
- Mungesa e ndihmës në detyra në shtëpi
- Mungesa e vullnetit për shkollim të vajzave

**Grafiku 4** - Disa nga vështirësitë konkrete me të cilat përballen këta fëmijë në nivelin parafillor dhe klasën e parë

#### 8.1.2 Stafi i shkollave, strukturat e shkollës, dhe Qendrat Mësimore

Në asnjërën nga shkollat e përfshira në këtë analizë, nuk ka mësimdhënës nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian, përkundër numrit të konsiderueshëm të nxënësve nga këto komunitete. Në anën tjetër në Prizren një mësimdhënëse e komunitetit rom mbanë orët e gjuhës rome për nxënësit në të gjitha shkollat e qytetit, si lëndë zgjedhore.

Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit- EPRBM krijohen si grupe taskforce brenda shkollave me përfaqësues nga të gjitha nivelet e arsimit në atë shkollë, psikologu, pedagogu, përfaqësues nga komu-

niteti i prindërve, si dhe kujdestari i klasës së caktuar në raste të caktuara. Sa i përket EPRBM-ve në nivel shkolle, në të gjitha shkollat e përfshira në analizë janë të themeluara dhe funksionale, sipas drejtorëve të shkollës. Në rastet e vijueshmërisë jo të rregullt, EPRBM varësisht nga rasti që ata evidentojnë në punën e tyre, referojnë ato në DKA, prej nga pastaj ato përcillen në organin kompetent, pra në QPS. Këto ekipe rifreskohen vit pas viti, në mënyrë që të mbahet tempo e lartë e angazhimit vullnetar në këto ekipe nga stafi i shkollës dhe prindërit.

Në kuadër të këshillave të prindërve të shkollave të përfshira në analizë, del se në 3 nga 4 shkollat këshilli i prindërve ka në përbërje edhe një prind përfaqësues nga komunitetet rom, ashkali, ose egjiptian. Për më tepër në Ferizaj në shkollën Naim Frashëri kryesuesi i Këshillit Drejtues të Shkollës është një ashkali, derisa në kuadër të këshillit të prindërve në këtë shkollë janë 2 prindër ashkali.

Në fund, të gjitha shkollat kanë raportuar bashkëpunim shumë të mirë me qendrat mësimore, megjithëse kanë shprehur se ka hapësirë për përmirësim dhe avansim të bashkëpunimit.

## **8.2 Pikëpamja e drejtorëve komunal për arsim dhe e zyrtarëve të zyrës komunale për komunitete dhe kthim**

### **8.2.1 Përfshirja e nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në klasat parafillore dhe klasën e parë**

Nga intervistat e realizuara me drejtor ose përfaqësues të drejtorive komunale për arsim në 4 komunat e përfshira në hulumtim, të gjithë vlerësojnë se përfshirja e nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në klasat parafillore dhe klasat e para të arsimit fillor, është deri diku e mirë, por njëkohësisht deklarojnë se ka hapësirë për përmirësim të situatës. Në takimet me autoritetet komunale, nuk ka qenë e mundur të identifikohen përpjekjet e bëra në nivel komunal për të rritur nivelin e pjesëmarrjes së nxënësve e as nuk është raportuar ndonjë e dhënë në monitorimin e braktisjeve individuale, apo të rasteve të mos-vijimit të shkollimit.

Në anën tjetër, në komunën e Fushë Kosovës programi për klasat parafillore nuk organizohet në shkollat e qytetit për shkak të mungesës së hapësirës fizike në shkollat e mbingarkuara me nxënës, dhe numrit të ulët të normave për angazhim të mësimdhënësve për këtë program – duke fokusuar të gjitha normat që kanë për mësimdhënës për t'u përballur me rritjen e vazhdueshme të numrit të nxënësve në nivelet fillor, të mesëm të ulët, dhe të mesëm të lartë në qytet. Megjithëse klasat parafillore organizohen në fshatra, dhe komuniteti ashkali që jeton në Fshatin Henc të kësaj komune është i përfshirë në këtë klasë, shumica e nxënësve rom, ashkali dhe ata egjiptian jetojnë në lagje të ndryshme të qytetit ku ky program nuk ofrohet.

Edhe pse në intervistat e realizuara të gjithë drejtorët ose përfaqësuesit e drejtorive komunal për arsim kanë deklaruar se regjistrimi në klasa parafillore dhe klasat e para është thuajse i plotë në komunat përkatëse (përjashtoj Fushë Kosovën që nuk ka program të tillë), ka qenë vetëm komuna e Prizrenit ajo që ka siguruar të dhëna në numra për këta fëmijë. Në komunën e Prizrenit deklarojnë se janë 84 nxënës në klasat parafillore nga këto komunitete, nga të cilët 42 janë vajza, derisa në klasën e parë janë 64 nxënës të regjistruar, nga të cilët 33 janë vajza. Është interesante të përmendet se në të dhënat vjetore të nxjerra nga SMIA për vitin akademik 2019/2020 rezulton se në Prizren janë 15 ashkalinjë dhe 37 rom, në Ferizaj janë 25 nxënës ashkalinjë në klasa parafillore, derisa në Obiliq vetëm 8 ashka-

linjë. Në Fushë Kosovë nuk ka asnjë nxënës të vetëm nga këto 3 komunitete në nivelin parafillos<sup>33</sup>. E gjetur mjaftë shqetësuese e analizës është se ka diskrepancë ndërmjet të dhënave të raportuara nga komunat dhe atyre të SMIA që përmbledhen në raporte vjetore të tyre.

## 8.2.2 Mos-regjistrimi dhe braktisja në klasën parafillore dhe klasën e parë

Në krye të listës së shkaqeveqë drejtorët apo përfaqësuesit e DKA-ve japin për mos-regjistrim, vijueshmëri të parregullt, apo edhe braktisje të shkollës në klasën parafillore dhe klasat e para nga nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, është vetëdijesimi i pamjaftueshëm i prindërve për rëndësinë e shkollimit të hershëm dhe atij fillor për fëmijët e tyre. Për më shumë, kushtet socio-ekonomike të familjeve të këtyre komuniteteve, distanca nga shkolla, pamundësia nga komuna për të siguruar transport të organizuar për fshatrat apo lagjet të cilat nuk plotësojnë kriteret e distancës, si dhe mungesa e modeleve apo shembujve të mirë nga vetë komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian që do të inspironin prindërit për të dërguar fëmijët në shkollë (përmendur nga përfaqësues të DKA në Obiliq), janë disa nga arsyet tjera të dhëna për mos-regjistrim apo edhe braktisje të shkollës. Sa i përket të dhënave mbi braktisjet, 2 nga 4 komunat kanë deklaruar se nuk kanë pranuar informata nga shkollat se ka braktisje në klasën parafillore apo klasën e parë, ndërsa në 2 komuna tjera kanë deklaruar se janë të vetëdijshëm se edhe pse edhe në numra shumë të vegjël në krahasim me vitet e mëhershme, braktisja është ende e pranishme. Në klasat parafillore drejtorët ose përfaqësuesit e DKA-ve e pranojnë që është e vështirë të shënohen rastet e vijueshmërisë jo të rregullt si braktisje edhe nëse nxënësit mungojnë mbi një muaj, duke arsyetuar se u japin kohë nxënësve të adaptohen gradualisht me ambientin e shkollës, orarin, shoqërinë, dhe rrethana të tjera me të cilat ata përballen për herë të parë. Fatkeqesisht të dhënat nuk janë raportuar në numra nga komunat, por as nga qendrat mësimore. Këtë vit ka qenë edhe më e vështirë të evidentohen të dhënat për shkak të organizimit të mësimin online për kohë të gjatë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid19.

Të gjitha komunat kanë hartuar dhe miratuar plane të veprimit për arsim, plane të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali, si dhe kanë të themeluar Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mos-regjistrimit (EPRBM) në nivel shkollash dhe komunash.

Përgjegjësia zyrtare për t'u marrë me regjistrimin dhe për të siguruar vijueshmëri të rregullt në klasën parafillore dhe klasën e parë, sipas të intervistuarve nga DKA-të është e ndarë në mes të DKA-ve, shkollave përkatëse, ZKKK-ve, Qendrave për Punë Sociale (QPS), si dhe është pjesë e punës së Qendrave Mësimore edhe pse jo në mënyrë zyrtare. Për më tepër, një nga të intervistuarit është shprehur se duhet bashkërendim më i mirë edhe me Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK), ndërsa një tjetër kanë përmendur rëndësinë e angazhimit aktiv të prindërve në këtë çështje.

Kampanjat vetëdijësuese për regjistrim dhe mos-braktisje janë cilësuar si të rëndësishme, dhe të gjithë të intervistuarit kanë deklaruar se po, duhet të bashkë-organizohen apo udhëhiqen nga komuna. Aktivitetet tjetër që është cilësuar unanimisht si i rëndësishëm, është shpërndarja e fletushkave tek prindërit për rëndësinë e programit parafillos dhe regjistrimit në klasë të parë. Në Prizren janë pajtuar se duhet të realizohen video promovuese në nivel komune apo vendi për vetëdijesim të prindërve, dhe kanë vlerësuar lartë punën e mediumit lokal në gjuhën rome, Radio Romano Avazo në vetëdijesimin e prindërve dhe fëmijëve për rëndësinë e shkollimit.

<sup>33</sup> Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020, faqe 27 - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

### 8.2.3 Rasti specifik i Zaskokut dhe Dubravës në Ferizaj

Fshati Zaskok në të cilin gjendet shkolla fillore Naim Frashëri e cila mbulon edhe fshatin Dubravë, është më pak se një kilometër larg Dubravës. Në këtë shkollë numri i përgjithshëm i nxënësve është 724 nxënës, nga të cilët 321 janë të komunitetit ashkali të cilët vijnë nga fshati fqinjë i Dubravës. Në këtë shkollë janë shënuar braktisje të shumta dhe vijueshmëri shumë e parregullt nga dhjetëra nxënës ashkali.

Në fund të periudhës së parë të vitit shkollor 2018-2019 është konstatuar se nga kjo shkollë, procesin mësimor e kanë braktisur 22 nxënës, kryesisht të komunitetit ashkali<sup>34</sup>. Një reagim nga Rrjeti kosovar për edukimin e fëmijërisë së hershme të komunitit rom, ashkali dhe egjiptian KRAEEN (Kosovo Roma, Ashkali and Egyptian Early Years Network), ka nxitur edhe inspektoratin komunal të arsimit në Ferizaj që të verifikoj situatën. Në procesverbalin me numër protokollit 195/19 të datës 23.04.2019, thuhet se arsye e braktisjes është situata sociale dhe niveli i ulët i arsimimit të prindërve. Në procesverbal thuhet se nga 22 nxënës që kanë braktisur shkollën, vetëm 2 janë rikthyer në shkollë me ndërmjetësimin e qendrës mësimore në Dubravë. Problem kryesor i evidentuar në këtë verifikim të gjendjes nga inspektorati komunal i arsimit është fakti se të dhënat mbi numrin e mungesave dhe braktisjet nuk vendosen në Sistemin për Menaxhimin e Informatave në arsim SMIA<sup>35</sup> nga shkolla. Për këtë ata tërheqin vërejtjen shkollës dhe kërkojnë që të gjitha informatat të barten në SMIA në afat prej 15 ditës. Në fakt një dukuri e tillë vlerësohet se është e pranishme gjithandej në shkollat e Kosovës, dhe rastet e mungesave për periudha të gjata kohore nuk vendosen në SMIA me kohë, dhe nuk raportohen si braktisje. Për më tepër, rastet e vijueshmërisë jo të rregullt për periudha të gjata kohore, nuk trajtohen me urgjencën e nevojshme as nga EPRBM-të.

Drejtoria për arsim në Ferizaj në anën tjetër deklaroi se ka marrë masa shtesë për përmirësimin e situatës në këtë fshat, duke dërguar psikologun në shkollë për të asistuar fëmijët në shkollë, si dhe kanë inspektuar në kapacitetet e tyre disa herë këtë shkollë si dhe fshatin, për të nxitur prindërit të regjistrojnë dhe sjellin fëmijët e tyre në shkollë. Megjithatë masat e ndërmarra nga komuna, situata mbetet e njëjtë sa i përket përfshirjes në klasat parafillore. Edhe pse të pa dokumentuara në numra konkret nga DKA, shkolla, apo qendra mësimore, të tri palët e pranojnë se ka ende braktisje në shkollën Naim Frashëri në numra brengosës.

### 8.2.4 Të punësuarit në klasat parafillore dhe shkollat fillore nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian

Nga 4 komunat e përfshira në hulumtim, të punësuar nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian në klasa parafillore apo shkolla fillore ka vetëm në komunën e Prizrenit, me 7 të punësuar gjithësej, nga të cilët 2 janë të angazhuar në klasat parafillore. Këto të dhëna nuk përputhen me të dhënat në Statistikat Vjetore në Arsim nga SMIA, ku në Prizren figurojnë vetëm 5 mësimdhënës të komunitetit rom, dhe 1 mësimdhënës ashkali në Ferizaj<sup>36</sup>. Në komunën e Prizrenit organizohet edhe mësimi në gjuhën rome, ku është e angazhuar një mësimdhënëse nga ky komunitet.

<sup>34</sup> Nxjerrë nga një reagimi i iniciuar nga Rrjeti KRAEEN (Kosovo Roma, Ashkali and Egyptian Early Years Network Rrjeti kosovar për edukimin e fëmijërisë së hershme të komunitit rom, ashkali dhe egjiptian)

<sup>35</sup> Sistemi i menaxhimit të informatave në arsim (SMIA) - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

<sup>36</sup> Statistikat Vjetore në Arsim 2019/2020, faqe 38 - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Në anën tjetër në komunat Fushë Kosovë, dhe Obiliq, ka dhjetëra mësime të angazhuar nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian si tutor apo vullnetarë në qendra mësimore, të cilët paguhet në bazë të projekteve të organizatave të cilat menaxhojnë me ato qendra. Të punësuar në shkollë si mësime nga komuna nuk ka. Ndërsa sa u përket konkurseve publike, në komunën e Fushë Kosovës kanë deklaruar që kandidatët nga këto komunitete nuk kanë plotësuar kriteret në konkurse publike në të kaluarën.

## 8.3 Pikëpamja e përfaqësuesve të qendrave mësimore


### 8.3.1 Programi i Qendrave Mësimore

Nga 4 komunat e përfshira në hulumtim, program parafillor, pra për grup moshat 5 deri në 6 vjeç ofrohet vetëm në qendrën mësimore në Dubravë të Ferizajit të menaxhuar nga Caritas Kosova, ku këtë vit kanë të regjistruar 30 nxënës, nga të cilët vetëm 8 janë vajza. Në Fushë Kosovë në qendrën e menaxhuar nga Balkan Sunflowers Kosova, e cila nuk është përfshirë direkt në këtë hulumtim me intervista, ofrohet program parafillor dhe kanë mesatarisht 80 fëmijë në vit që ndjekin programin në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Për dallim nga Dubrava ku fëmijët nuk ndjekin programin në shkollën fillore në fshatin Zaskok për shkak të distancës në këmbë dhe rreziqeve gjatë rrugës, mungesës së transportit të organizuar, por edhe për shkak të neglizhencës së prindërve, në Fushë Kosovë fëmijët ndjekin programe edhe në shkollë edhe në qendër (përveç programit parafillor që nuk ofrohet në shkollë por vetëm në qendër). Në anën tjetër në Obiliq fëmijët ndjekin programin parafillor vetëm në shkollën publike të qytetit dhe fshatit Plemetin. Përveç programin në qendër, stafi i të gjitha qendrave mësimore ofron mbështetje teknike në procesin e regjistrimit të fëmijëve në shkollë. Fatkeqësisht program parafillor nuk ofrohet në qytetin e Fushë Kosovës, ndërsa në të gjitha lokacionet tjera të përfshira në analizë po.

Sa i përket programit, të gjitha qendrat punojnë duke u bazuar në kurrikulën e MASHT për këtë nivel, por duke përshtatur aktivitetet për rrethanat e nxënësve me të cilët ata punojnë. Ata deklarojnë që programi që qendrat mësimore ofrojnë pak ose fare nuk dallon për nga cilësia me programin që ofrojnë në shkollë apo institucione parashkollore. Ky program realizohet nga një staf kryesisht jo i kualifikuar (përveç në Ferizaj), por që kanë një përvojë solide në mësime, dhe kanë ndjekur trajnime të shumta në këtë fushë si dhe janë monitoruar rregullisht nga organizatat të cilat i përkrahin. Programi parafillor nuk ofrohet në qendrat mësimore në Obiliq, të përfshira në këtë analizë, sepse tash e disa vite shkollat mbulojnë në masë të madhe këtë program edhe për nxënësit nga komunitetet rom dhe ashkali në këtë komunë, prandaj edhe qendrat mësimore gradualisht kanë hequr dorë nga ofrimi i këtij programi.



### Stafi i Qendrave Mësimore që punojnë në programin parafillor



**Grafiku 5** – Stafi i Qendrave Mësimore që punojnë në programin parafillor

Të intervistuarit nga qendrat mësimore në Fushë Kosovë dhe Ferizaj deklarojnë se prindërit janë mjaftë të interesuar që fëmijët e tyre të ndjekin programin parafillor, por jo edhe në Prizren dhe Obiliq. Edhe në rastet kur prindërit shfaqin interes të dërgojnë fëmijët në parafillor, ata nuk interesohen shumë më pas për mbarëvajtjen e programit apo përfitimet dhe të arriturat e fëmijëve të tyre. Në anën tjetër situata me braktisje në programin parafillor, cilësohet si vështirë e matshme për shkak të vijueshmërisë jo të rregullt, duke përmendur raste të nxënësve që nuk vijnë mbi një muaj, dhe pastaj rikthehen sërish në proces mësimor. Të gjithë të intervistuarit deklarojnë se braktisje këtë vit nuk ka pasur, por janë përballur me vijueshmëri jo të rregullt nga shumë nxënës. Një ndër arsyt që përmendet për mos regjistrim të të gjithë nxënësve në Ferizaj në klasë të parë për shembull, është vonesa në rregullim të dokumentacionit – mos nostrifikimi me kohë i tyre për nxënësit e ri-atdhesuar.

### 8.3.2 Vështirësitë e prindërve dhe qendrës mësimore

Disa nga vështirësitë e prindërve të fëmijëve rom, ashkali, dhe egjiptian për t'i dërguar fëmijët e tyre në program parafillor janë se nuk janë të njoftuar me rëndësinë e programit parafillor, nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet që dalin nga dërgimi i fëmijëve në parafillor, ose konsiderojnë se mungon përkrahja nga shkolla dhe mësimdhënësit për të lehtësuar kyçjen e nxënësve në shkollë në moshë të hershme.

Qendrat mësimore kanë raportuar vështirësi për t'i bindur prindërit që të sjellin fëmijët e tyre në qendër, vështirësi për të siguruar vijueshmëri të rregullt të fëmijëve, vështirësi financiare për të organizuar aktivitete (kryesisht në sigurimin e pagave dhe mjeteve didaktike), por kohëve të fundit edhe vështirësi të krijuara nga pandemia Covid-19<sup>37</sup>.

37 Përshkrimi i virusit Covid-19 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë - OBSH


Të intervistuarit kanë deklaruar se kanë raporte të mira me DKA-në, QPS-në, ZKKK (edhe pse thonë që është se bënë shumë për komunitetin), si dhe me shkollat përkatëse. Të tjerë akterë që ata kanë përmendur si bashkëpunorë janë edhe zyra e kryetarit të komunës (në Fushë Kosovë shprehen se ka ndihmuar shumë qendrën mësimore të The Ideas Partnership), Avokati i Popullit, Policia, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, dhe organizata të tjera lokale. Të gjitha këto bashkëpunime vlerësohen si të mira në përgjithësi, por që ka hapësirë për më shumë bashkëpunim dhe përafrim të punëve të cilat ndajnë të njëjtin qëllim.

## 8.4 Pikëpamja e prindërve

### 8.4.1 Përshtypjet e përgjithshme të prindërve mbi programin parafillos dhe fillor, si dhe përfshirjen e fëmijëve të tyre këto programe


Të gjithë prindërit e intervistuar e përzgjedhur për intervistë, kishin fëmijë që aktualisht janë të regjistruar në klasën parafillore, ose në klasën e parë e më lartë. Përkundër faktit se përfaqësuesit e qendrave mësimore dhe drejtorët e shkollave në përgjithësi deklarojnë se mungon vetëdijësimi i prindërve rom, ashkali, dhe egjiptian për rëndësinë e regjistrimit në shkollë, të gjithë prindërit shprehen se është shumë me rëndësi që fëmijët e tyre të ndjekin programin parafillos, sepse në këtë nivel ata mësojnë gjuhën në të folur, shkronjat dhe numrat, si dhe sjellje e disiplinë në veçanti, e kjo është e rëndësishme për fëmijët rom sidomos të cilët gjuhën amëtare e kanë gjuhën rome, dhe programi i përgatitë ata në gjuhën shqipe ose serbe. Kjo më vonë në klasë të parë ju shërben jashtëzakonisht shumë për të zënë hapin me fëmijët e tjerë shqiptar (apo serb, varësisht nga lokacioni dhe shkolla ku ata vijnë), dhe për të krijuar shoqëri me të tjerët.

#### Fëmijët e prindërve të intervistuar (sipas klasave)



**Grafiku 6** – Stafii i Qendrave Mësimore që punojnë në programin parafillos

Të gjithë prindërit pa përjashtim në pyetjen me opsione mbi atë se çfarë përmirësimesh kanë vërejtur tek fëmia i tyre i cili apo e cila ka ndjekur programin parafillor (qoftë në shkollë apo në qendër mësimore), kanë zgjedhur të gjitha opsionet e ofruara.




**Grafiku 7** – Përmirësimet që prindërit kanë vërejtur tek fëmijët e tyre pasi kanë ndjekur programin parafillor

Në përgjithësi prindërit janë shprehur se programi parafillor duhet të ndihmojë ata të njihen në formën bazike me numrat, shkronjat, ngjyrat, të përmirësojnë të folurit e tyre në gjuhën zyrtare të vendit ku ata jetojnë dhe shkojnë në shkollë, si dhe të mësojnë të shoqërohen me fëmijët e tjerë e të kenë sjellje më të mira me ta e me mësuesin e tyre.

Shumica e prindërve deklarojnë se informatat për programin parafillor i kanë marrë nga OJQ-të e ndryshme dhe qendrat mësimore me të cilat ato menaxhojnë. Për shembull në Fushë Kosovë të gjithë prindërit kanë përmendur organizatat Balkan Sunflowers Kosova (BSFK) dhe The Ideas Partnership si burim të informacionit për këtë program, duke deklaruar thuajse unanimitisht se asnjëherë nuk janë kontaktuar nga shkolla apo komuna. Është me rëndësi të ritheksohet se në Fushë Kosovë programi parafillor nuk ofrohet nga shkollat publike të qytetit, dhe kopshtet private janë kryesisht të papërbalueshme në çmime për prindërit rom, ashkali, dhe egjiptian.


**A jeni kontaktuar apo vizituar nga shkolla apo komuna në lidhje me programin parafillor për fëmijët tuaj?**



**Grafiku 8** – Përgjigjet e prindërve mbi pyetjen se a janë kontaktuar apo vizituar nga shkolla apo komuna për programin parafillor

Të pyetur për vështirësitë që ata kanë për të dërguar fëmijët e tyre në program parafillor apo edhe në shkollë fillore, shumica e prindërve kanë deklaruar se nuk kanë ndonjë vështirësi. Ndërkaq, pjesa tjetër e prindërve janë shprehur se distanca dhe mungesa e përcjelljes apo transportit për fëmijët e tyre është në krye të listës së sfidave. Në shumicën e lagjeve apo fshatërave ku banojnë komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian mungon infrastruktura rrugore, sinjalistika, trotuarët, ndriçimi, dhe nuk pastrohen gjatë dimrit nga bora e akulli. Problem tjetër i theksuar është edhe prania e madhe e qenve endacak, sidomos e theksuar në fshatin Plemetin të Obiliqit. Nga ndërtesat sociale apo edhe shtëpitë e fshatit Plemetin e deri në shkollën Pandeli Sotiri ka shumë hapësira e shtëpi të pabanuara të cilat përbëjnë strehë për qentë endacak të cilët rrezikojnë fëmijët, por edhe të rriturit. **Të tjera vështirësi** të përmendura janë edhe situata e tyre ekonomike, që si pasojë u pamundëson atyre t'u sigurojnë fëmijëve veshëmbathje të përshtatshme për shkollë.

### Vështirësitë e prindërve për të dërguar fëmijët e tyre në parafillor dhe shkollë fillore




**Grafiku 9** – Përgjigjet e prindërve mbi pyetjen se cilat janë vështirësitë e tyre për të dërguar fëmijët në programin parafillor dhe shkollën fillore

#### 8.4.2 Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali, dhe egjiptian në klasat parafillore

Derisa në qytetin e Fushë Kosovës nuk ofrohet program parafillor në shkollat publike dhe të gjithë prindërit e intervistuar dërgojnë fëmijët e tyre në qendrën mësimore të BSFK-së, lokacionet e tjera të përfshira në këtë hulumtim të gjitha kanë një program të tillë në shkollat afër apo në lagjet dhe fshatrat përkatëse. Megjithatë, në fshatin Dubravë të gjithë prindërit e intervistuar kanë thënë se nuk i dërgojnë fëmijët e tyre në parafillor në shkollën Naim Frashëri në fshatin Zaskok, i cili është më pak se një kilometër larg, por zgjedhin t'i dërgojnë në qendrën mësimore të menaxhuar nga Caritas Kosova, për shkak të afërsisë me shtëpitë e tyre – dhe rreziqeve përgjatë rrugës për në shkollën në Zaskok. Në anën tjetër, në Prizren tre nga katër prindërit e intervistuar kanë dërguar fëmijët e tyre në kopshte private edhe në nivelin parafillor. Në fshatin Plemetin të Obiliqit, përkatësisht prindërit e intervistuar që jetojnë në ndërtesat sociale, të gjithë kanë deklaruar se për shkak të vështirësive të elaboruara më lartë, nuk i dërgojnë fëmijët në program parafillor në shkollë. Në anën tjetër prindërit e fëmijëve që vijnë në shkollën në gjuhën serbe Sveti Sava, poashtu në Plemetin, katër nga katër të intervistuar kanë pohuar se fëmijët e tyre kanë ndjekur klasën parafillore **në shkollë** he automatikisht janë regjistruar në klasë të parë në po atë shkollë.

### Ku e kanë ndjekur fëmijët tuaj programin parafillor?



**Grafiku 10** – Përgjigjet e prindërve mbi pyetjen se ku e kanë ndjekur fëmijët e tyre programin parafillor

Të pyetur nëse programi parafillor i ofruar në qendrën mësimore të lagjes apo fshatit të tyre mjafton dhe fëmijët nuk kanë nevojë të shkojnë në shkollë, në Fushë Kosovë të gjithë prindërit e intervistuar kanë deklaruar se programi i qendrës mësimor është mëse i mjaftueshëm për fëmijët e tyre. Kjo mesiguri se derivon nga fakti se këta prindër asnjëherë nuk kanë pasur rastin të dërgojnë fëmijët e tyre në program parafillor në shkollë në këtë qytet, dhe programi i qendrës mësimore është i vetmi që ata njohin.

Katër nga katër prindërit e intervistuar në Dubravë të Ferizajit kanë deklaruar se programi i qendrës nuk mjafton por e plotëson atë të shkollës (edhe pse kjo bjen në kundërshtim me faktin që asnjëri nga ta nuk i dërgon fëmijët në programin parafillor në shkollë). Përgjigje të njëjtë sikurse në Dubravë kanë dhënë edhe prindërit nga Prizreni, dhe ata nga Plemetini (edhe në fshat edhe në ndërtesat sociale).

## 9. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME PËR PALËT E INTERESIT

- Në bazë të rezultateve nga intervistat e realizuara me drejtor komunal të arsimit, përfaqësues të ZKKK-ve, drejtor të shkollave, dhe përfaqësues të qendrave mësimore del që një ndër arsyet kryesore për regjistrim dhe vijueshmëri jo të kënaqshme të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë është niveli i njohurive që kanë prindërit e tyre për rëndësinë e shkollimit, e në veçanti në nivelin e klasave parafilllore. Prandaj rekomandohet të punohet më tepër në ndryshimin e qasjes së prindërve mbi edukimin parafillor, por edhe atë fillor, gjë që duhet të bëhet me përpjekje të të gjithë akterëve të përfshirë në këtë fushë. Është me rëndësi jetike që shkollat të rrisin bashkëpunimin e tyre me prindërit dhe komunitetin në mënyrë që të arrihet një ndikim më i madh në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e arsimit të fëmijëve të tyre, si dhe përfshirjes sociale.
- Edhe pse vështirë i matshëm përmes intervistave dhe përgjigjeve që shumica e respondentëve japin për çështjen e diskriminimit në shkolla, një observim i thjeshtë i procesit mësimor, ambienteve të brendshme të shkollave nga realizuesi i analizës, por edhe nga përgjigjet e dhëna nga prindërit, del se ka ende diskriminim në forma të ndryshme në shkolla, të cilat ndikojnë jashtëzakonisht keq në formësimin e personalitetit të këtyre fëmijëve dhe të arriturave të akademike të tyre. Prandaj duhet të punohet më tepër me shkollën për të luftuar diskriminimin, i cili është i pranishëm në të gjitha shkollat. Kjo është një përpjekje mbarëshoqërore dhe duhet të përfshijë të gjithë akterët.
- Në përgjigjet e prindërve është vërejtur se përkundër vlerësimit ndryshe të akterëve të tjerë të përfshirë në këtë analizë, ata konsiderojnë se ndikimi i mësimdhënësve dhe qasja e tyre janë qenësore për zhvillimin e fëmijëve të tyre. Prandaj, rekomandohet që mësimdhënësit dhe menaxhmenti i shkollave të trajnohen dhe të aftësohen në angazhimin e tyre për një shkollë gjithëpërfshirëse. MASHT dhe DKA-të duhet të angazhohen për të ofruar module trajnimit mbi luftimin e racizmit dhe ksenofobisë në shkolla.
- Duke qenë se nga shumica e prindërve të intervistuar është përmendur se në shkolla ku fëmijët e tyre vijnë nuk ka mësimdhënës nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian, por edhe kanë shumë pak mundësi të takojnë individë të suksesshëm nga komunitetet të cilave ata u përkasin, rekomandohet që në programet e qendrave mësimore duhet të përfshihen individë të suksesshëm nga komunitetet e tyre si modele të mira për nxënësit që t'i ndjekin.
- Të rritet numri i mësimdhënësve nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian në shkollat e Kosovës në përgjithësi, e në veçanti në shkollat të cilat kanë numër të konsiderueshëm të nxënësve nga këto komunitete.
- Një tjetër e gjetur e analizës është se një ndër arsyet pse fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian nuk vijnë në programin parafillor apo nuk vijnë në klasë të parë është distanca nga shkolla dhe rreziqet me të cilat ata mund të përballen duke përshkuar këtë distancë. Andaj, rekomandohet që të bëhet më shumë nga ana e komunave për të siguruar transport të organizuar ose përcjellës për nxënësit të cilët nuk mund të shkojnë në shkollë për shkak të distancës,

ku rrezik paraqesin edhe qentë endacak. Për më tepër, rekomandohet të punohet edhe në një zgjidhje për qentë endacak që paraqesin rrezik për fëmijët, si dhe në rregullimin e infrastrukturës rrugore dhe sinjalistikës aty ku ka nevojë.

- Duke qenë se klasat parafillore nuk janë obligative, duhet të bëhet më tepër nga ana e shkollës dhe komunës për t'i detyruar prindërit të dërgojnë fëmijët e tyre për të ndjekur këtë nivel, dhe tutje rekomandohet që këto klasa të bëhen të detyrueshme. Krahas kësaj të krijohen kushte për organizim të këtyre klasave në mbarë vendin në mënyrë që prindërit të marrin seriozisht rëndësinë e këtij programi.
- Edhe pse në Kosovë është investuar në masë të konsiderueshme në infrastrukturë në arsim, shkollat vazhdojnë të jenë shpesh herë objekte jo shumë të dashura për fëmijët për shkak të mënyrës së organizimit, ngjyrave, e sistemimit të brendshëm fizik. Kjo si pasojë ndikon negativisht në zhvillimin social dhe emocional të fëmijëve, dhe si e tillë rekomandohet të krijohet ambient më atraktiv dhe më të pranueshëm brenda saj, si dhe më miqësor për fëmijët. Infrastruktura duhet të ju përgjigjet nevojave të këtyre grupmoshave si atyre fizike - ashtu edhe atyre psikologjike. Është shumë me rëndësi pajisja e kopshteve publike klasave parafillore dhe qendrave mësimore me materiale didaktike dhe mjete konkretizuese të shëndetshme.
- Identifikimi i hershëm i rasteve në rrezik për braktisje ose mosregjistrim në klasa parafillore dhe klasë të para ndihmon në eliminimin e këtyre fenomeneve. Realizimi i vizitave sistematike në shtëpi nga ana e shkollës bashkë me profesionistët shëndetësor dhe social, për të bërë identifikimin dhe menaxhimin e hershëm të rasteve dhe ofrimin e mbështetjes për prindërit për regjistrimin e fëmijëve në program parafillor është tjetër rekomandim i nxjerrur në bazë të të gjeturave të projektit.
- Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i regjistrimit, vijueshmërisë dhe përfshirjes në klasë të nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian si proces, do të ndihmonte në uljes e numrit të rasteve të mosregjistrimit dhe do të siguronte vijueshmëri më të rregullt.
- Përpjekjet e akterëve relevant duhet të orientohen drejt matjes së të nxënësve në mënyrë që të jemi në gjendje të përcjellim përparimin dhe të arriturat e tyre, veç pjesëmarrjes. Kjo matje do të mund të përfshinte arsimimin që fëmijët e marrin në shkollë, por edhe ato që mësojnë në qendrat mësimore.
- Stafi i Qendrave Mësimore, mësimdhënësit dhe stafi menaxhues i shkollave, si dhe EPRBM-të të mbledhin të dhëna në mënyrë sistematike dhe të monitorojnë sigurinë e përgjithshme në shkollë për nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian, në mënyrë që rastet e ofendimeve apo ngacmimeve në shkollë të parandalohen dhe trajtohen.
- Të ketë koordinim më të mirë në mes të DKA-ve dhe drejtorëve të shkollave në sigurimin e informatave të sakta të cilat barten në SMIA pastaj, për shkak se në shumë raste është hasur në diskrepancë në të dhënat mbi numrin e nxënësve si dhe atë të mësimdhënësve.





